

URDHËR
Nr. 64, datë 30.3.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Oltjon Muzaka, lidhur me trajtimin e praktikës me nr. 538 prot., datë 19.3.2021, mbi miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar.
2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm z. Oltjon Muzaka.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj